



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gnjilane  
Municipal Gjiçan  
Gilan Belediyesi

## DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe në Rregulloren së Komunës së Gjiçanit për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve Nr.016-126422, dt.29.12.2016, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-Gjiçan shpall:

### THIRRJE PUBLIKE

2024

#### **Për mbështetje financiare publike të Individëve dhe OJQ-ve në projektet me aktivitete kulturore, sportive, dhe rinore në Komunën e Gjiçanit**

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Komunës së Gjiçanit, u bënë thirrje Individëve dhe organizatave të regjistruara si OJQ në Republikën e Kosovës, programi i të cilëve është i fokusuar në Komunën e Gjiçanit, që të aplikojnë për mbështetje financiare për projekt-propozimet të cilët përmbushin objektivat e përgjithshme si në vijim:

- Promovimin e artit përmes pasurimit, diversifikimit, barazisë gjinore dhe rritjes së cilësisë së jetës kulturore;
- Nxitin vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve në jetën kulturore përfshirë barazinë gjinore;
- Fuqizimi i koordinimit dhe partneritetit ndërmjet institucioneve të kulturës dhe shoqërisë civile duke respektuar ligjin për barazi gjinore;

Të drejtë aplikimi me projekt-propozime në këtë thirrje publike kanë OJQ-të dhe Individët që dëshmojnë se veprojnë në Komunën e Gjiçanit dhe realizojnë aktivitetet e tyre në Komunën e Gjiçanit.

OJQ-të dhe Individët mund të aplikojnë vetëm në njërin nga kategoritë në vijim:

1. Mbështetje për projektet e aktiviteteve të Kalendarit Vjetor 2024;
2. Projekte artistike, krijuese të të gjitha formave;

**3. Projekte në fushën e sportit, të të gjitha disiplinave;**

**4. Projekte rinore;**

**5. Kategoria e veçantë;**

OJQ-të dhe Individët mund të aplikojnë me më së shumti 1 projekt-propozim në një nga pesë kategoritë (kategoria 1, 2, 3, 4 dhe 5) të kësaj thirrje publike. Katër kategoritë e caktuara më sipër janë shtjelluar më poshtë, duke zbërthyer synimet dhe aktivitetet përkatëse, fushëveprimin, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për aplikuesit, si dhe shkallën maksimale dhe minimale të mbështetjes.

**Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:**

**Faza I:** Vlerësimi administrativ, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

**Faza II:** Vlerësimi i përmbajtjes:

- Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon;
- Nëse aplikuesi ka paraparë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të paraqitur në këtë thirrje publike;
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrje publike;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

**Aplikimi:**

Të gjitha detajet e aplikimit duhet të lexohen në formularin: Udhëzimet për Aplikantët, i cili është publikuar në kuadër të kësaj thirrje.

**Afati për aplikim:**

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati

i fundit për aplikim është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së kësaj thirrje publike dhe përfundon me datën: 20 Mars 2024, në ora 16:00.

#### **Më shumë informacione rreth thirrjes publike:**

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar pyetjet e mundshme jo më pak se 8 ditë (13.03.2024, 16:00h) para përfundimit të thirrjes për aplikim.

E-mail : [dkrs.gjilan@rks-gov.net](mailto:dkrs.gjilan@rks-gov.net);

#### **KATEGORIA E PARË:**

#### **Mbështetje për projektet e aktiviteteve të Kalendarit Vjetor 2024**

Synimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është që aktivitetet e parapara në kalendarin vjetor të organizohen mirë dhe të jenë me cilësi të lartë.

Në këtë kategori parashihet mbështetja e OJQ-ve të cilat janë të organizuara mirë, kanë vizion të qartë dhe strategji konkrete e të qartë të veprimit, dhe kanë dëshmuar kapacitet profesional dhe teknik për zbatimin e strategjisë së tyre. Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për zhvillim organizativ dhe programor, synohet:

1. Fuqizimi i skenës së pavarur kulturore përmes zhvillimit të organizatave të dëshmuara të profilizuara në fushën përkatëse;
2. Rritja e cilësisë së krijimtarisë artistike;
3. Fuqizimi i partneritetit në mes të institucioneve publike dhe komunitetit kulturor në zhvillimin dhe zbatimin e politikave adekuate publike për fushën e kulturës, rinisë, dhe sportit;
4. Shkëmbimi i njohurive dhe ngritja e vetëdijes rreth rëndësisë së aktiviteteve që realizohen në ato data kalendarike;
5. Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve;
6. Nxitja për organizmin e ngjarjeve sportive me rëndësi;

#### **Kush mund të aplikojë:**

• OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Gjilanit, të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

#### **Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;

- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat linja buxhetore të financuara nga DKRS/Gjilan.
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Të ofroj dëshmi se OJQ-ja ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2023.
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.

#### **Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon, me përvojë të dëshmuar në programe dhe aktivitete përkatëse;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore).

#### **Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:**

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi brenda vitit 2024 të parapara sipas Kalendarit Vjetor.

#### **Shkalla e mbështetjes:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 6,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

#### **KATEGORIA E DYTË:**

**Projekte artistike, krijuese të të gjitha formave**

Synimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është të nxisë krijimtarinë artistike, krijuese të të gjitha formave që përfaqësojnë vlera dhe barazi gjinore.

Kjo kategori synon mbështetjen e OJQ-ve dhe Individëve në fusha si në vijim:

- Artin muzikor dhe vallëzimin;
- Artin skenik, përfshirë regjinë, monodramat, shkrimi i dramës, film i metrazhit të shkurtër etj.;
- Artin tradicional, përfshirë punime artizanale etj.;

- Artin letrar, përfshirë letërsinë artistike, poezinë, letërsinë për fëmijë, kritikën etj.;
- Të tjera.

Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për krijuesit/artistët synohet:

- Vazhdimësia e jetës artistike, paraqitje inovative;
- Pasurimi i shprehjes krijuese artistike bashkëkohore;
- Gjenerimi i kuadrove të reja profesionale, të cilët do të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë profesionale në fushën e krijimtarisë artistike e kulturore;
- Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në fushën krijuese të të gjitha formave artistike;

#### **Kush mund të aplikojë:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Gjilanit, të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.
- Individët nga Komuna e Gjilanit.

#### **Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2023.
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat linja buxhetore të financuara nga DKRS/Gjilan.;
- Të mos kenë aplikuar me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

#### **Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore);

**Kriteret e veçanta për individ të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore).

**Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:**

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2024.

**Totali i shumës për mbështetje në këtë kategori:**

- Shuma totale e planifikuar e mbështetjes është 70,000.00 Euro

**Shkalla e mbështetjes për OJQ:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 6,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

**Shkalla e mbështetjes për Individ:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 1,500.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

**KATEGORIA E TRETË:**

**Projekte në fushën e sportit, të të gjitha disiplinave**

Synimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është të nxisë sa më shumë Individë dhe OJQ të organizojnë ngjarje sportive të mirëfillta në disiplina të ndryshme sportive.

Kjo kategori synon mbështetjen e OJQ-ve dhe individëve nga fusha e sportit, në veçanti:

- Gjimnastikë;
- Sporte akrobatike;
- Sporte luftarake;
- Futboll;
- Basketboll;
- Hendboll;
- Volejbol;
- Sportet në rrugë;
- Sportet e motorizuara;

- Etj

#### **Kush mund të aplikojë:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Gjilanit, të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.
- Individët nga Komuna e Gjilanit.

#### **Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2023.
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat linja buxhetore të financuara nga DKRS/Gjilan.
- Të mos kenë aplikuar me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

#### **Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore)

#### **Kriteret e veçanta për individ të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore).

#### **Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:**

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2024.

#### **Totali i shumës për mbështetje në këtë kategori:**

- Shuma totale e planifikuar e mbështetjes është 110,000.00 Euro

#### **Shkalla e mbështetjes për OJQ:**



- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 8,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

#### **Shkalla e mbështetjes për Individ:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 1,500.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

### **KATEGORIA E KATËRT:**

#### **Projektet rinore**

Synimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është të promovojë vullnetarizmin, të krijojë kushte për edukim jo-formal, të nxisë të rinjtë për të mësuar, të nxisë organizimin e kurseve/seminareve për aftësimin e të rinjve duke përforcuar organizatat rinore në ngritjen e kapaciteteve profesionale që promovojnë paqe, tolerance ndëretnike duke përfshirë barazinë gjinore.

Në këtë kategori parashihet mbështetja e projekt-propozimeve të OJQ-ve dhe Individëve të profilizuar në rini, me synim:

- Promovimin, pasurimin dhe diversifikimin e jetës rinore përmes aktiviteteve gjithëpërfshirëse në fusha të ndryshme edukative. Aktivitetet specifike që jetësojnë këtë synim mund të konsiderohen:
  - Organizimi i seminareve, kurseve, punëtorive, debateve, tryezave, ligjëratave, hulumtimeve, simpoziumeve dhe konferencave për aftësimin e të rinjve;
  - Organizimi i fushatave të vetëdijesimit si: edukimi shëndetësor duke e përfshirë kujdesin e shëndetit mendor dhe edukimi seksual. Ndërgjegjësimi e parandalimi ndaj dukurive të ndryshme negative tek të rinjtë si narkotikët, pirja e duhanit, alkooli, ekstremizmi dhe radikalizmi i dhunshëm;
  - Promovimi i diversitetit kulturor, integrim i grupeve rinore urbane/rurale, grupeve të marginalizuara dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve nga zona dhe komunitete të ndryshme etnike;
  - Organizimi i ngjarjeve të ndryshme gjatë ditëve të diasporës përmes aktiviteteve rinore;
  - Edukimi fizik i të rinjve dhe fëmijëve përmes sportit dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në kulturë dhe sport;
  - Nxitje të vullnetarizmit;
  - Promovim i talentëve të rinjë;
  - Të tjera

#### **Kush mund të aplikojë:**

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Gjilanit, të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.
- Individët nga Komuna e Gjilanit.



### **Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2023.
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat linja buxhetore të financuara nga DKRS/Gjilan.;
- Të mos kenë aplikuar me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

### **Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore);

### **Kriteret e veçanta për individ të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore).

### **Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:**

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2024.

### **Totali i shumës për mbështetje në këtë kategori:**

- Shuma totale e planifikuar e mbështetjes është 50,000.00 Euro

### **Shkalla e mbështetjes për OJQ:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 6,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

### **Shkalla e mbështetjes për Individ:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 1,500.00 Euro

- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

## KATEGORIA E PESTË:

### Kategoria e veçantë

Synimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është të përkrahë organizatat e dala nga lufta të regjistruara si OJQ për aktivitetet e tyre vjetore, e poashtu të nxisë krijimtarinë artistike për OJQ-të që shënojnë data të rëndësishme të festave të kalendarit komunal (data që përkujtojnë deshmoret dhe heronjtë, apo data nga e kaluara historike) përmes aktiviteteve të tyre përmes kulturës dhe sportit, (qofshin ato edhe aktivitete jo të drejtpërdrejta për festën kalendarike, por aktivitete përcjellëse si psh: Orkester frymore që i begaton aktivitetet për shënimin e këtyre datave) si dhe në sektorin e sportit të përkrahë klubet e regjistruara si OJQ, vecanërisht klubet ekipore të cilat garojnë në superligën e Kosovës dhe klubet ekipore që janë kampionë aktual nga edicioni i kaluar në superligë.

### Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Gjilanit, të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon, me përvojë të dëshmuar në atë sektor, dhe që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

### Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Nëse ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2023.
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat linja buxhetore të financuara nga DKRS/Gjilan.;
- Të mos kenë aplikuar me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrje publike.

### Kriteret e veçanta për OJQ të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën përkatëse me atë projekt që aplikon;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore)

**Kriteret e veçanta për individ të përcaktuara me dispozitat në vijim:**

- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit(dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore).

**Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:**

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2024.

**Totali i shumës për mbështetje në këtë kategori:**

- Shuma totale e planifikuar e mbështetjes është 110,000.00 Euro

**Shkalla e mbështetjes për OJQ:**

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 30,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 500.00 Euro

Drejtori: Kushtrim Zeqiri

